



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

U D H Ë Z I M

**MBI RREGULLAT E PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE TË SHOQËRIVE TË
SIGURIMIT, SHOQËRIVE TË BROKERIMIT NË KUADRIN E
TRANSPARENCËS NDAJ PUBLIKUT DHE MBROJTJEN KONSUMATORE**

Miratuar me vendimin e Bordit nr.11, datë 08.02.2007

Baza ligjore

Ky udhëzim hartohet në bazë dhe për zbatim të Kreut X, nenit 75, të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

1. Objekti i këtij udhëzimi është:

- i) Përcaktimi i rregullave për publikimin e të dhënave të nevojshme për të bërë të mundur njohjen nga publiku të gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit dhe për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë së sigurimit për pagimin e dëmshpërblimeve dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera.
- ii) Përcaktimin e rregullave për dhënien e informacionit konsumatorit përpara lidhjes së kontratës së sigurimit, ose gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së sigurimit.

Shoqëria e sigurimit publikon të dhënat mbi veprimtarinë e saj sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

Transparenca ndaj publikut.

2. Informacioni i publikuar nga shoqëria e sigurimit duhet :

- a) Të jetë i përshtatshëm për të bërë të mundur marrjen e një vendimi nga publiku.
- b) Të jepet në kohë dhe të jetë i përditësuar.
- c) Të jetë i besueshëm dhe të shërbejë si bazë për marrjen e një vendimi nga publiku.
- d) Të jetë i disponueshëm për të gjithë dhe pa kosto.
- e) Të jetë i plotë dhe i kuptueshëm për të bërë të mundur krijimin e një opinionimi sa më të saktë për tregun e sigurimeve.
- f) Të jetë i krahasueshëm midis shoqërive të ndryshme të sigurimit dhe i vazhdueshëm në kohë.

3. Shoqëria e sigurimit publikon një raport vjetor, i cili përfshin raportin vjetor financiar dhe të dhëna të tjera të përfshira në këtë udhëzim. Ky raport publikohet, jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik.

4. Raporti vjetor financiar përfshin:

- a) Bilancin vjetor.
- b) Llogarinë fitim-humbje.
- c) Lëvizjen e mjeteve monetare.
- d) Llogaria e fitime dhe humbje për veprimtarinë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- e) Aftësinë paguese aktuale.
- f) Raportin përmbledhës për shoqërinë e sigurimit të përgatitur nga shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar.

5. Përveç sa parashikohet në pikën 4 të këtij udhëzimi, raporti përfshin :

- a) Ndarjen e portofolit të investimeve sipas kategorive të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- b) Të dhëna vjetore mbi primet dhe dëmet sipas klasave ku ka ushtruar aktivitetet.

c) Vlerën, kohën dhe natyrën e përgjegjësive përfshirë këtu ato ekzistuese dhe të pritshme (do të jepet në total të përgjegjësive.)

d) Tregues bazë (raporte) që rrjedhin nga të dhënat e llogarisë fitim-humbje dhe të dhënat e qarkullimit të mjeteve monetare, siç janë raporti dëme- prime , raporti i kombinuar dëme-prime që llogaritet si raport i dëmeve të ndodhura plus shpenzime të përgjithshme ndaj primeve neto të shkruara, raportin e aftësisë paguese që llogaritet si raport i primeve të fituara duke zbritur primet e kaluara në risigurim ndaj kapitalit të shoqërisë, raporti i pagimit të dëmeve që llogaritet si raport i dëmeve të paguara ndaj dëmeve të ndodhura.

e) Raportimi i numrit dhe vlerës së dëmeve të paguara dhe të ndodhura.

6. Të dhënat mbi veprimtarinë bazë të shoqërisë dhe drejtimin e saj përfshijnë:

a) Strukturat drejtuese të shoqërisë dhe listën emërore të tyre.

b) Statusin ligjor të shoqërisë së sigurimit, apo të grupit në të cilin ai bën pjesë.

c) Listën e aksionerëve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin aksioner.

d) Marrëveshjet që shoqëria e sigurimit ka lidhur me të tretë për kalimin në sipërmarrje të funksioneve të veçanta të veprimtarisë së tij, ose aleanca strategjike nëse ka të tilla.

e) Informacion për shpenzimet që bën shoqëria për kërkime dhe zhvillimin e biznesit për trajnime të stafit dhe reputacionin, tregtimin e produkteve të reja.

f) Shtrirja territoriale e shoqërisë së sigurimit (degë, filiale, zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë vendit)

Mbrojtja konsumatore

7. Shoqëria e sigurimit dhe ajo e brokerimit, përveç sa është parashikuar në Kreun X të ligjit nr.9267, datë 29.07.2004, detyrohen të informojnë të siguarin për produktin e sigurimit, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit, përfitimet që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, tarifat dhe primet që i siguruari duhet të paguajë.

8. Përpara lidhjes së kontratës, shoqëria e sigurimit dhe ajo e brokerimit informon konsumatorin në gjuhën shqipe dhe në mënyrë të qartë për:

a) Emrin dhe formën ligjore të shoqërisë.

- b) Adresën e zyrës qendrore apo të degës e cila merr përsipër të lidhë kontratën e sigurimit.
- c) Kushtet e kontratës së sigurimit.
- d) Përkufizimet e terminologjisë së kontratës së sigurimit.
- e) Periudhën e vlefshmërisë së kontratës së sigurimit.
- f) Totalin e primit dhe primet e ndara sipas rreziqeve të veçanta (nëqoftëse kontrata e sigurimit mbulon rreziqe që i përkasin disa klasave të sigurimit.)
- g) Shuma e taksave, komisionet dhe shpenzime të tjera që i ngarkohen primit dhe shuma totale e pagueshme.
- h) E drejta për të shtyrë apo zgjidhur kontratën e sigurimit.
- i) Pagesën e primit dhe kohëzgjatjen e pagesës.
- j) Proçedurat dhe mënyrën e pagimit të dëmit.
- k) Ligji i cili aplikohet në rastet kur nuk është përcaktuar nga palët në kontratën e sigurimit.

9. Në rastet e sigurimit të jetës, shoqëria e sigurimit dhe ajo e brokerimit përveç sa është parashikuar në pikën 8 të këtij udhëzimi, informon si më poshtë:

- a) Bazat dhe kriteret për shpërndarjen e fitimit.
- b) Tabelën e vlerave të dorëzimit të kontratës së sigurimit.
- c) Ligji tatimor i aplikueshëm.
- d) Informacion në lidhje me trajtimin e ankesave, ekzistencën e një strukture ankimiimi përpara se një konflikt i lindur midis shoqërisë së sigurimit dhe të siguarit të kalojë në proçes gjyqësor.

10. Gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi, shoqëria e sigurimit dhe ajo e brokerimit informon të siguarin përveç kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit edhe për:

- a) Çdo ndryshim të emrit të shoqërisë së sigurimit apo brokerimit, formën ligjore të tij, adresën e selisë qendrore apo degës e cila ka marrë në sigurim.
- b) Çdo ndryshim të informacionit të parashikuar në pikën 9 të këtij udhëzimi.
- c) Çdo ndryshim në kushtet e kontratës së sigurimit në fuqi si rezultat i ndryshimit të ligjit të aplikueshëm të kësaj kontrate.

d) Çdo vit, informacion për bonuset apo përfitimet e të siguruarit, aty ku janë të aplikueshme.

Ky udhëzim hyn në fuqi në datën e miratimit.

Elisabeta GJONI
KRYETAR